

studimi
historik

Cila është historia e simboleve dhe flamujve shqiptarë nga Mesjeta deri në ditët e sotme. Si kanë ndryshuar format dhe cilat janë elementët e një tradite dikur shumë të zhvilluar

Heraldika shqiptare, tradita e hum

ARMAND PLAKA

Duke iu referuar një studiuës të shquar italian të heraldikës e të simboleve kombëtare shqiptare, Giovanni Armitotta, që nga fundi i shekullit të 19, deri në periudhën e Pavarësisë, njihen shumë flamuj. Në fakt ato përmbajnë edhe simbole të tjera, që s'kanë të bëjnë me atë kryesorin, pra, shkabën dykrenare, e që rrënjët e tyre i kanë nga influencat e huaja e përkatësitë fetaro-politike, por që fillojnë e sfumohen si traditë e fenomen me kalimin e kohës. Por nga ky aspekt, ato tashmë mbartin vetëm vlera studimore, ndryshe nga shumë shtete të tjera sot në Evropë apo dhe në Ballkan, që pas rënies së Perdes së Hekurt, përjetuan rikthimin në simbolet e mitet e vjetra. Nga koha e mbretit Vid për shembull, deri në përfundimin e Luftës së Parë Botërore (1914-1918), kemi 8 flamuj. Nga koha e qeverisë së Regjencës deri në të ashtuquajturën Republika I, e deri në përfundimin e periudhës së Mbretërisë (1918-1939), numërohen rreth 16 flamuj.

Që nga koha e pushtimit italian, ose siç njihet zyrtarisht asokohe, "Unione Personale con l'Italia" e deri në periudhën e qeverisë demokratike (1939-1946), numërohen 11 flamuj. Gjatë periudhës së monizmit (1946-1991), njihen 2 flamuj, përveç flamujve që përdomin flota luftarako-detare, flota tregtare (1946-1991) e që numërojnë plot 11 flamuj. Nga fillimi i pluralizimit (1991), 2 flamuj e 3 simbole shtetërore.

Origjina e heraldikës

Por gjithçka që trajtuam deri më tani përbën vetëm një pjesë të vogël të një teme shumë të gjërë e me shtrirje shumë të gjatë në kohë. Kjo pasi simboli apo emblema e shkabës se zezë dykrenare, që ne shqiptarëve na identifikon kaq mirë ndër popuj të tjerë, ka lidhje me një fushë studimore jo shumë të rrahur në vendin tonë, por shumë të vlerësuar nga studiues të ndryshëm botërorë e evropianë. Kjo fushë është heraldika. E në vazhden e studimeve të tyre, arrihet në mendimin se "në Ballkan, heraldika së pari filloi të praktikohet te arbrit". Heraldika si disiplinë e ka fillimin e praktikimit në Evropë në shekullin e XI, kohë kur filluan të kristalizohen rregulla në paraqitjen e simboleve në armët ushtarake, vulat dhe flamujt e feudalëve, shteteve e koalicionëve ushtarake. Këto simbole që në fillim u praktikuan për qëllime identifikimi, më vonë u zhvilluan edhe në drejtimin artistik të tyre dhe në momentin që ata filluan të krijonin rregullsi, edhe njohje individualiteti të feudalëve, shteteve etj.. Kjo tërësi rregullash u kristalizua në një disiplinë, e cila duhej njohur nga bashkëkohësit për nevojat e organizimit politik, ushtarak e shoqëror. Kjo disiplinë u emërua "heraldikë", nga emri i atij personi që kishte detyrë të njihje këtë rregullsi të fqinjët, eprorët e feudalit që i



Vula e Skënderbeut



Objekt studimi të heraldikës janë edhe vulat që ishin të domosdoshme për aktivitetin e kancelarive të oborreve e të shtetit mesjetar shqiptar. Nga ato të dhëna të pakta, kjo edhe për mungesë studimesh e gjurmimesh, na janë ruajtur dhe kemi dëshmi për këtë fushë që në literaturën shkencore quhet sfragistikë. Kemi dëshmi grafike për vulën e Gjon Kastriotit, vulën e Gjergj Strazimir Balshës e kemi dëshmi, por nuk e njohim paraqitjen grafike të tyre për vulën e qytetit të Durrësit, të qytetit të Himarës, të Ulqinit, Tivarit, Lezhës. Edhe gjatë pushtimit turk, vazhduan të ruajnë për korrespondencën e tyre vulat, peshkopët si Bardhi e Mekajshi që në emblemat e tyre kishin simbolin e derës fisnike që i përkisnin etj. Por shumë e rëndësishme në

këtë drejtim është se njohim vulën e kryezotit të shtetit shqiptar të shekullit XV, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, e cila ruan edhe simbolin e flamurit tonë kombëtar. Nga Kuvendi i Dukagjinit i viteve 1601-1602, ku morën pjesë përfaqësues nga 13 krahina që nga Kosova, Dukagjini, Shpati e Myzeqeja, në përpjekje për çlirim nga pushtuesi, aktet i vulosën me vulën, forma grafike e së cilës na është ruajtur edhe në ditët e sotme. Ajo ka mbishkrimin: "Sigillum Regni Macedoniae et Albaniae", Vula e Mbretërisë së Maqedonisë dhe Shqipërisë, e cila ka edhe ajo në mes shqiponjës dykrenore, të trashëguar dhe bashkudhëtare të shqiponjës së flamurit të kombit tonë.

shërbente, të vasalëve të tij dhe të mbretit nga i cili varej. Heraldikë kishte detyrë të drejtonte ceremonitë e oborreve, të mbante të vizatuara emblemat, vulat dhe flamujt e të gjithë atyre që kishin të bënin me zotin e tij. Emblemat ndryshonin, por tashmë me rregullsi dhe të shpallura publikisht.

Shqipëria mesjetare

Në Shqipërinë mesjetare kemi shembuj nga të gjitha këto raste të ndryshimit në vazhdimësi të emblemat. Në trojet shqiptare, heraldika u zhvillua dhe u praktikua që në fillimet e saj në Evropë, si rezultat i kontakteve me ushtritë evropiane të kryqëzatave që zbritën në bregdetin Adriatik. Këtë fakt e kanë pranuar studiuesit e heraldikës, por mbështetjet gjithashtu dhe me dëshmi monumentale heraldike. E shekullit XII është emblema heraldike e shtetit të Arbrit e zbuluar në Gëzic

“
Albanologu kroat, Milan Shuflai, shkruan: “...Ndër tokat shqiptare, heraldika u përdor herët në ceremoni e kancelari... qysh në kontaktet me anzhuinët dhe kalorësit francezë...”

(Mirditë), po kështu e kësaj periudhe është edhe emblema e vjetër e Muzakajve, që mban një burim uji dhe dy pishtarë. Për përfaqimin e disiplinës heraldike te arbrit ndikuan shumë faktorë ekonomikë e kulturorë, por po veçojmë vetëm dy nga këto. Në këtë periudhë, për vetë pozicionin në të cilin ndodhet, vendi ynë njohu një zhvillim ekonomik e shoqëror. Në një udhëpërshkrim të fillimshekullit XIV shkruhet: "Vendi (Arbëria) është i ndarë midis princave të vendit, të cilët e sundojnë vetë atë, pa iu nënshtruar kërkujt..."

Heraldikat arbëreshe

Albanologu kroat, Milan Shuflai, shkruan: "...Ndër tokat shqiptare, heraldika u përdor herët në ceremoni e kancelari... qysh në kontaktet me anzhuinët dhe kalorësit francezë...". Për zhvillimin e heraldikës ndikoi edhe

ndërgjegjja e arbërve si vazhduese e lashtë në trojet e veta, ku ishin ruajtur në mitologji, tregime e gojëdhëna, ornamente veshjesh etj, simbole të paraardhësve që nga lashtësia, të cilat të konkretizuara ishin dhe në monumentet që ruheshin në çdo cep të truallit tonë. Pra, si popull, kishim një trashëgimi simbolesh shumë të pasur, e cila gjallonte në objekte të kulturës materiale bashkë me shpjegimin mitik, ritual etj. Emblema e shtetit të Arbrit e shek. XII ishte e vendosur në një ansambël arkitektonik me vlera artistike dhe mbishkrimi që e shoqëron është latinisht e sferave të larta kulturore të kohës, dhe emblema është e një cilësie që tregon dorën e një artisti të vërtetë. Stema heraldike e Topiajve e shek XIV, që ruhej në Manastirin e Shën Gjon Vladimirit, Elbasan (sot në Muzeun Kombëtar Tiranë), vlerësohet në përputhje të plotë me të gjitha rregullsitë

SIMBOLI KOMBETAR NE RRJEDHEN E HISTORISË



1912

Flamuri i pavarësisë



1928-1939

Flamuri i Mbretërisë së Zogu I



1939-1943

Flamuri i periudhës së pushtimit Italian

bur



flamuri

Raporti i dimensioneve të flamurit tashmë është: 1 x 1,4. Sipas ligjit, çdo shtetas shqiptar ka të drejtën e mbajtjes e përdorimit të flamurit kombëtar, ndërsa për institucionet publike është i detyrueshëm në mjediset e jashtme e të brendshme

heraldike që kishte kjo disiplinë në atë periudhë. Ajo është gdhendur nga mjeshtri vendas, Dhimitër Spada, shoqërohet me mbishkrimin në tri gjuhë: latinisht, greqisht e sllav-

isht, që tregon se edhe kasneci (Heraldi) i asaj dere fisnike shqiptare, ishte me një kulturë të lartë dhe artist i vërtetë.

Stemat, faza më e lartë artistike

stema

Stema e shtetit ka pamjen e një shqyti të kuq me shqiponjën dykrenare të zezë. Më 21 tetor 1998, stemës i shtohet përkrenarja e Gjergj Kastrioti Skënderbeut, duke e kthyer, si për ironi të fatit aty ku ka qenë edhe në periudhën e Zogut, vetëm se në rastin e fundit, përkrenarja shfaqet duke treguar profilin në anën tjetër

Meqë përmendëm fjalën stemë, duhet të dimë që kjo kupton fazën më të lartë të zhvillimit artistik e disiplinor të heraldikës. Në fillim ishin përbërës të heraldikës vetëm forma e shqytit dhe simboli (një ose disa) të paraqitura në ngjyra dhe më vonë kësaj baze ju shtuan edhe elementë të tjerë, po sipas një rregullsie të përcaktuar. Tërësia e këtyre elementëve dekorativo-artistikë u mbiquajt stemë. Por nuk ka heraldikë pa bazën e saj që është emblema (simboli), e cila i plotëson kriteret disiplinore edhe kur është e vetme pa shtesat e mëvonshme. P.sh., i plotëson kërkesat e heraldikës edhe emblema e Arbrit, që ka vetëm simbolin shqiponjë, po ashtu si dhe emblema e Topiajve që ka simbolin në shqyt, helmetën, kreshitën, kurorën, pëlhurën dhe pendët. Monumentet heraldike që ruhen në truallin autokton shqiptar, janë të pak-

TRADITA

Simbolet dhe luftërat

Në Mesjetë dyert fisnike kishin edhe flamurët e tyre që kryesisht kishin të njëjtin simbol si emblemat heraldike. Me krijimin e shtetit shqiptar, nga Kuvendi shqiptari Lezhës më 2 mars 1444 edhe kombi ynë unifikoi e njohu si flamur të tij flamurin që deri atëherë ishte i dinastisë Kastrioti. Në luftë, të gjithë repartet e fisnikëve shqiptarë mbanin flamujt e tyre, por në ballë të luftës e të ceremonive të tjera, ishte flamuri i mbarë kombit. Sipas hulumtimeve e dëshmime arkivore shqiptare e të huaja, rezultoi se flamuri kombëtar shqiptar, megjithëse i ndaluar nga pushtuesit, u ruajt e u praktikua në ngjarje historike të krahinave të atdheut tonë pa ndërprerje deri më 28 nëntorin e 1912-ës.

Flamuri shqiptar, ndryshimet që nuk preken

Flamuri kombëtar është një simbol shumë i respektuar për shqiptarët kudo që ndodhen, brenda apo jashtë vendit amë. Respekti për të buron nga respekti për atdheun e të parëve, luftën dhe veprën e tyre për të na lënë trashëgim atë që kemi sot. Por objekt i shkrimit tonë të sotëm nuk është domethënia apo diskutimi mbi simbolikën që përmban në vetvete flamuri ynë kombëtar, por versionet e shumta që ka njohur ai ndër shekuj, e më konkretisht, për periudhën më aktive në këtë drejtim, pra, nga fundshekulli i 19-të e deri në ditët tona. Fillimisht, forma e shkabës së zezë dykrenare mbi fushën e kuqe nuk ka qenë kjo që njohim në ditët e sotme. Ajo nuk ka pasur këtë formë kaq klasike, por ka njohur forma që shumëkush dëshiron t'i përdorë akoma edhe sot e kësaj dite, pra, më natyrale e ndoshta, edhe më të bukura. Shpeshherë ajo është shoqëruar me simbole të tjera, duke filluar që nga përkrenarja e Skënderbeut e deri te yjet me pesë apo me gjashtë cepa. Edhe ngjyra e kuqe, në sfond të flamurit, ka ndryshuar shpesh forcën apo tonin, duke u dukur herë më e zjarrtë e herë më e mbyllur, gati në të murme.

Forma e simbolit

E kështu është një fakt i njohur se gjatë kësaj kohe kanë dalë plot qeveri e grupe politike, të cilët kanë dashur ta rishikojnë disa herë formën e simbolit kombëtar si për të treguar se me to fillon ndryshimi. Kështu, për shembull, njihen disa versione të ndryshme gjatë kohës së periudhës së viteve të para të pavarësisë e të krijimit të shtetit të ri shqiptar si; vitet e Këshillit të Regjencës, Republikës Autonome Franceze të Korçës, Republikës Parlamentare në fillim të viteve '20 dhe kohës së Mbretit Zog. E më pas, ato pasohen me veshjen e shkabës shqiptare me simbolet e kohës së pushtimit fashist të Shqipërisë (sëpatat romake), qeverisë së kohës së pushtimit gjerman (këshilli i regjencës). Kjo periudhë pasohet nga një periudhë shumë e gjatë, ajo e regjimit komunist, periudhë e cila njohu vënie e yllit pesëcepësh me nuanca të verdha në krye të shkabës dykrenare. Edhe forma e shqiponjës tashmë njohu një ndryshim, megjithëse jo shumë të madh, por që gjithsesi vihet re qartë, pasi u bë më klasike dhe iu largua versionit të mëparshëm që ngjiste më shumë me "shpendin krenar" në origjinalin e tij. Por kjo punë nuk mbaroi me kaq. Me rënien e komunizmit, kjo punë u mendua të rishikohet edhe një herë e sigurisht, edhe stemën e republikës. Tashmë sigurisht u hoq ylli pesëcepësh dhe për disa kohë pasoi konfuzion, i cili u pasua me vënie apo rivënie e përkrenares së Skënderbeut mbi shkabën e zezë, e cila, pak a shumë, ka mbetur në formë e njëjtë me atë të kohës së monizmit. Në legjislaturë e para të Kuvendit të ri, pas vitit nëntëdhjetë, pati tentativa apo mendime për ta riparë formën e saj e për t'ia përshtatur modeleve të hershme, pra, të mos ishte si një stampë, kaq klasike, por më natyrale e ndoshta të dukeshin edhe forma e pendëve apo lupave në trupin e krahët e saj. Por flamuri nuk njeh vetëm një version, pasi edhe vetë ato, sipas funksioneve që përdoren, ndryshojnë shpesh edhe formën dhe përmbajtjen. Kështu, p.sh., flota luftarako-detare ka flamurin e saj të dallueshëm qartë nga flamujt e tjerë që përdoren për ceremoni shtetërore, njësi të tjera ushtarake e pse jo, edhe shoqata e grupe të tjera qeveritare e joqeveritare përgjatë kohërave.

Modifikimet e flamurit

Por le të kalojmë te aktualiteti dhe duke iu referuar anës ligjore shohim se flamuri tashmë ka vetëm elementin e shqiponjës dykrenare të zezë në fushën e kuqe. Stema e shtetit ka pamjen e një shqyti të kuq me shqiponjën dykrenare të zezë. Më 21 tetor 1998, stemës i shtohet përkrenarja e Gjergj Kastrioti Skënderbeut, duke e kthyer, si për ironi të fatit aty ku ka qenë edhe në periudhën e Zogut, vetëm se në rastin e fundit, përkrenarja shfaqet duke treguar profilin në anën tjetër. Pamjen definitive të simbolit tonë kombëtar ia jep ligji i miratuar në Kuvendin Popullor më datë 22 korrik 2002, ku pjesa e caktuar për flamurin përcaktonte se përbëhet prej këtyre elementëve: një fushë e kuqe gjaku me një shqiponjë të zezë dykrenare në mes, me krahët të hapur anash. Secili krah i shqiponjës ka 9 pendë e bishti ka gjithsej shtatë. Raporti i dimensioneve të flamurit tashmë është: 1 x 1,4. Sipas ligjit, çdo shtetas shqiptar ka të drejtën e mbajtjes e përdorimit të flamurit kombëtar, ndërsa për institucionet publike është i detyrueshëm në mjediset e jashtme e të brendshme.

Dyert e mëdha Emblemat e famshme

Nga faza e parë e zhvillimit të kësaj discipline të heraldikës shqiptare, sot njihen emblemat e fisnikëve Balsha, Muzaka, Topia, Skuraj, Bue Shpata, Engjëllorët, Bukja, Arani, Buzezi, Dukagjini, Dushmani, Gropa, Himara, Kopili, Matranga, Tribal-di, Zakarija, Spani etj. Nga dinastitë arbërore kemi emblemat e Kastriotëve, të Shtetit të Arbrit të shekullit XII dhe emblema e "Mbretërisë Shqiptare", nën sovranitetin e Anzhuinëve e fundit të shek XIV etj. Zhvillimi i shoqërisë shqiptare pësoi një frenim si rezultat i pushtimit otoman, që fisnikërinë shqiptare ose e përndoqi nga adheu, ose e detyroi të bëhej vasale e Portës së Lartë, e cila nuk e njihje as nuk e lejonte heraldikën. Gjatë kësaj periudhe, ashtu sikurse e gjithë kultura kombëtare, pësoi goditje edhe heraldika, e cila ishte faktor dhe tregues i zhvillimit kulturor e shoqëror i kombit tonë përkrah vendeve evropiane.

ta, për arsyt që dihen; duket se pushtuesit e shpesh të kanë punuar sistematikisht për zhdukjen e këtyre monumenteve që dëshmonin fazën e lartë të qytetërimit të kombit tonë në Mesjetën e vonë. Nga pushtimi i serbëve në vitin 1912 u zhdukën tri emblema në kalanë e qytetit të Lezhës, po nga trazirat e këtij fillim shekulli u zhdukën disa emblema nga muret e kështjellës së Durrësit, gjatë gjysmës së parë të shek XX u zhduk emblema me shqiponjën dykrenare në Jabllanicë (Kosovë), në vitin

1912 u grabitën gurët e disa varreve monumentale nga serbët në periferi të Tetovës, gjatë trazirave të vitit 1997, u zhduk emblema e shtetit shqiptar të Skënderbeut në portën e kështjellës së Himarës, e mund të rendisim edhe fakte të tjera të njohura. Për fat, na janë ruajtur në truallin tonë emblema e Skurajve, Engjëllorëve, Topiajve, e Kastriotëve, Gropajve, Shtetit të Arbrit e disa emblema të tjera të gdhendura në gur ose të pikturuara, e disa të tjera të pidentifikuara nga studiuesit.



1943 - 1944

Flamuri i Këshillit të Regjencës gjatë pushtimit Gjerman



1946-1991

Flamuri i periudhës moniste



1991-2002

Flamuri i periudhës Demokratisë